



Pranuar / Dorezuar Prijemno/Prodato Received/Delivery	23 . 11 . 2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	7365/2022		1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr. 896/2022

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga; Eshref Shabani kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.896/2022, të datës 12.10.2022, së ankuesit [redacted] me adrese banimi [redacted] nga [redacted] kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47, 48 paragrafi 1 dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.11.2022, mori këtë.

### V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.Nr.896/2022, të datës 12.10.2022, së ankuesit [redacted]

II. MBETET NË FUQI, Vendimi i datës 07.02.2022, i Kryetarit të Komunës së Prishtinës, si dhe përgjigja në kërkesë e datës 13.09.2022, e U,D Menaxherit të Personelit në Komunën e Prishtinës.

### Arsyetim

Ankuesi [redacted] me datë 12.10.2022, me numër protokolli 6108/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me kompensim e pagës për ndërrimin gjatë natës në mënyrë retroaktive nga viti 2014 e tutje.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 20.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës. Ndërsa me datë 04.11.2022, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave**, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr 896/2022, datës 12.10.2022 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 23.08.2022; përgjigje në kërkesë e datës 13.09.2022; Vendimi i datës 07.02.2022, i Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Vendimi i datës 13.12.2021, me numër protokoli 6060/2022, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për pagese retroaktive nga data 07.02.2022, deri me datën 30.06.2022, Kërkesë për pagese retroaktive nga data 01.07.2022, deri me datën 31.08.2022; Lista e pagave; Akt Emërimi i datës 01.07.2017; Përgjigje në ankesë e datës 04.11.2022, me numër protokoli 6738/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.12.2021 A. Nr. 914/2021, ka nxjerr vendim me të cilin ankuesit **\_\_\_\_\_** i ka aprovuar pjesërisht ankesën duke e obliguar Kryetarin e Komunës së Prishtinës dhe Udhëheqësin e Personelit, që në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh të bëjë realizimin e shtesës për punën me ndërrime, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Me qëllimin të zbatimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kryetari i Komunës së Prishtinës, me datë 07.02.2022, me numër protokoli 14-020/01-26085/22, ka nxjerr vendim me të cilin ka zbatuar vendimin e Këshillit. Kolegji konstaton së Komuna e Prishtinës, në rastin e zbatimit të vendimit të Këshillit, ka vepruar në pajtime me nenin 21 paragrafi 1,2 të Ligjit Nr. 06/L -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku thuhet se; 1. Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. 2. Zbatimi i vendimit duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit të Këshillit.

Kolegji, pasi që i ka analizuar pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën, përgjigjes në ankesës, administrimit të provave relevantë të ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit Komuna e Prishtinës, si dhe pretendimin e ankuesit për pagesë retroaktive dhe ndërlidhur me Vendimin e KPMSHCK të datës 13.12.2021 me nr. A. Nr. 914/2021, ka konstatuar se Komuna e Prishtinës në plotësi ka zbatuar obligimin e KPMSHCK sipas obligimeve ligjore, dhe se pretendimet e ankuesit janë të pa bazuar sepse Komuna e





Prishtinës, ka bërë zbatimin e vendimit të Këshillit, nga data e lëshimit të Vendimit të Këshillit.

Kolegj për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar së U. D, Menaxherit të Personelit në Komunën e Prishtinës, me rastin e nxjerrjes së përgjigjes në kërkesës të datës 13.09.2022 , me numër protokoll 14-117/01-11369/22, ka vepruar në pajtim Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, Rregulloren Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, duke vërtetuar drejte gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me pretendimet ankimore për ankuesin [REDACTED] lidhur me kompensimin e pagesës për shtesës për pune me ndërrime.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
*Lënda me numër A.nr.896/2022*

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

Ankuesit

- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.